

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mafia shqiptare në Amerikën Latine, nga kokaina te pastrimi i parave
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1390619.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 09:49:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	10 shtator 2026, 09:34:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 10 shtator 2026, 09:33:00 UTC → 10 shtator 2026, 09:35:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	519630be6eac2fdf2a8e66e4132e04d497ac1ecffb456da5112e43cdb07c7001
TEKSTI	4cd7fb5ce0ad3694ee2912eedca770fd79a2078a2d68f96f825a1547c09b00b2
PAMJA	4e30ccc362d57537384285eafc5efa926eafff4c365fd6bc1a50d38c835a4488

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7744c3cdae4d73850ca15c8e744b61fc3237a196e58ac7454292dbd231f219e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	34cfec7b42024a092bf203c97a492b18db27ae0bb9e086c8d52cca38cd5ff992
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7744c3cdae4d73850ca15c8e744b61fc3237a196e58ac7454292dbd231f219e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mafia shqiptare në Amerikën Latine, nga kokaina te pastrimi i parave

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 10.09.2026, 11:34



Share



Share



Rrjetet kriminale shqiptare po zgjerojnë aktivitetin e tyre në Amerikën Latine duke u orientuar gjithnjë e më shumë drejt logjistikës, financave dhe infiltrimit të ekonomive të ligjshme, sesa kontrollit territorial me dhunë. Kjo është teza e analizës së Henry M. Rodríguez, doktor në Politika Publike nga Universiteti IEXE në Meksikë dhe këshilltar në fushën e sigurisë publike e private, botuar nga "La Tercera". Sipas analizës, pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri në vitet '90, grupet kriminale u zgjeruan drejt Evropës Perëndimore dhe më pas drejt Amerikës Latine, duke u organizuar në klane familjare dhe duke krijuar lidhje me aktorë vendas e ndërkombëtarë.

Një nga rastet e përmendura është ai i Dritan Gjickës, struktura e të cilit, sipas analizës, kombinonte trafikimin e kokainës me pastrimin e parave përmes kompanive fasadë dhe infiltrimin në sektorin e bananeve në Ekuador. Artikulli sjell edhe të dhënat për rritjen e sekuestrimeve të kokainës në Ekuador, nga 80 tonë në vitin 2019 në 226 tonë në vitin 2025, ndërsa gjatë periudhës 2019-2025 janë sekuestruar gjithsej 835 tonë. Përmendet gjithashtu Dritan Rexhepi, i cili dyshohet se ka koordinuar dërgesa narkotikësh edhe nga burgu deri në vitin 2021, duke ilustruar mënyrën se si rrjetet mund të vazhdojnë aktivitetin edhe pas arrestimit të drejtuesve. Analiza i referohet edhe Gavin Voss nga InSight Crime, si dhe rasteve të shqiptarëve në Peru të përfshirë në role financiare e logjistike.

Sipas Rodríguez, zgjerimi i këtyre rrjeteve lidhet me fitimet e jashtëzakonshme të trafikut ndërkombëtar të kokainës dhe me rolin e porteve të Amerikës Latine në furnizimin e tregjeve globale. Artikulli thekson se përgjigjja e shteteve nuk duhet të kufizohet vetëm te operacionet policore, por të përqendrohet në gjurmimin e parave, kontrollin e kompanive fasadë, forcimin e kontrolleve në porte dhe sistemeve të migracionit, si dhe bashkëpunimin inteligjent mes Ekuadorit, Kolumbisë, Perusë dhe Brazilit. Në analizë argumentohet se sfida kryesore nuk është më vetëm lufta ndaj një organizate kriminale, por goditja e kushteve ekonomike dhe institucionale që i lejojnë këto rrjete të depërtojnë në ekonominë e ligjshme.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat



Alleanza për
Media
Etike

ARTIKULL JOETIK?

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

[Puno me ne!](#)

[Marketing](#)

[Politika e privatësisë](#)

[Rreth Nesh](#)

[Kushtet e përdorimit](#)

[Kontakt](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.